



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.654/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Rrustem Thaqi dhe Ferki Xhaferi anëtare, duke vendosur përkritazi me ankesat e organizatës joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, të paraqitura kundër Subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale të datës 17.10.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 20.10.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. PRANOHEN të bazuara ankesat Anr.654/2021 dhe Anr.655/2021 të datës 18.10.2021 të paraqitura nga organizata joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, ndërsa Subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës, i shqiptohet gjobë, në lartësi prej 1,000.00 euro (njëmijë) për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, me rastin e thyerjes së heshtjes zgjedhore përmes rrjeteve sociale, për Zgjedhjet Lokale të datës 17.10.2021.

II. DETYROHET Subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), që gjobën e shqiptuar si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e marrjes së këtij vendimi, nën kërcënim e shqiptimit të dënimit shtesë.

A r s y e t i m

Me datë 18.10.2021, PZAP-i ka pranuar ankesat, Anr.654/2021 dhe Anr.655/2021 të datës 18.10.2021 të paraqitura nga organizata joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, kundër Subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës, në të cilat pretendon se me datë 17.10.2021 kandidatët për kuvend komunal nga ky subjekt Hazibije Shala dhe Burim Krasniqi nga Rahoveci kanë thyer heshtjen zgjedhore, ku me anë të rrjetit social Facebook kanë sponsorizuar postime me anë të të cilave kanë kërkuar nga qytetarët që ti votojnë të njëjtit. Këto postime të sponsorizuara u janë shfaqur përdoruesve të rrjetit social Facebook në ditën e zgjedhjeve dhe në këtë mënyrë konsiderojmë që ka ndikuar tek të njëjtit për mënyrën e votimit.

Ankesave u kanë bashkangjitur edhe fotografi si dëshmi.

Përgjigje në ankesa nuk ka paraqitur Subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës, edhe pse e njëjta është njoftuar me kërkesë për përgjigje në ankesë.

PZAP-i, pas shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesave dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, provave materiale, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesat janë të bazuara

Paneli, pasi ka vlerësuar pretendimet në ankesat Anr.654/2021 dhe Anr.655/2021 të datës 18.10.2021, të cilat për nga përmbajtja janë të njëjta, për nga natyra e shkeljes së pretenduar janë të njëjta, paraqitës i ankesave është organizata joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova dhe po ashtu të njëjtat janë paraqitur kundër subjektit të njëjtë politik Lidhja Demokratike e Kosovës, prandaj Paneli, bazuar në nenin 8 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave Nr.02/2015, të PZAP-it, në të cilën përcaktohet se: *“Me qëllim të lehtësimit të shqyrtimit të ankesave kryesuesi i panelit vendimmarrës mund të vendos ta bëjë bashkimin e ankesave që përmbajnë në vete çështje të ngjashme dhe se ato ankesa të trajtohen me një vendim”*, bëri bashkimin e ankesave dhe për të njëjtat vendosi me një vendim, si në dispozitiv të këtij vendimi.

Nga shkresat e lëndës shihet se Subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovë, konkretisht kandidatët për kuvend komunale nga ky subjekt Hazibije Shala dhe Burim Krasniqi nga Rahoveci, gjatë heshtjes zgjedhore dhe ditës së votimit në rrjetet e tyre sociale në Facebook përmes postimeve të sponsorizuara, kanë bërë fushatë zgjedhore me anë të të cilave kanë kërkuar nga qytetarët që ti votojnë të njëjtin, e me këtë veprim kanë bërë thyerjen e heshtjes zgjedhore.

Paneli, konform nenit 8 par. 5 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr. 02/2015, ndërmori hetim lidhur me pretendimet e paraqitësit të ankesës, dhe gjeti se të njëjtat pretendime janë të bazuara, për faktin se në llogarinë e Facebook-ut, ashtu siç pretendon paraqitësi i ankesës për postimet e Hazibije Shala dhe Burim Krasniqi, në ditën e heshtjes zgjedhore, të njëjtat postime të sponsorizuara kanë qenë aktive me datë 18.10.2021, në ora 16:42 dhe në këtë mënyrë kanë thyer heshtjen zgjedhore në ditë e votimit.

Paneli, vendimin e tij e mbështet në dëshmi të qarta dhe bindëse, konform nenit 117 par.3 të LZP-së, andaj nuk i mori parasysh pretendimet e paraqitësit të përgjigjes në ankesë, pasi që nga ana e tyre nuk u ofrua ndonjë dëshmi e cila argumenton pretendimet e tyre.

Andaj Paneli, duke iu referuar të cekurave më lart dhe në mbështetje të dispozitave ligjore të LZP-së konstaton se Subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës, është përgjegjëse për veprimet e saja, pasi që me veprimet e lartcekura ka shkelur nenin 36 paragrafi 1 pika b) të LZP-së, që përcakton se: *“veprimet e ndaluara para procesit të votimit ku thuhet se 24 orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës, deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohet bërja e fushatës në çfarëdo mënyre”*.

Paneli, me rastin e shqyrtimit të gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, u mbështet në dispozitat e lart cituara, e në veçanti duke marr parasysh rrethanat e rastit siç janë: natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj, në procesin zgjedhor, shkallën dhe peshën e shkeljes, faktin se subjekti politik të cilit i është shqiptuar gjoba, ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së

Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, vlerëson se gjoba e shqiptuar si masë, përveç aspektit të dënimit në raport me subjektin që nuk e ka respektuar Kodin e Mirësjelljes, shërben edhe si masë preventive që në të ardhmen subjektet politike të përmbahen nga veprimet e tilla që bien ndesh me rregullativën ligjore, që cenojnë të drejtën apo lirinë e votimit, në mënyrë që të sigurohet klimë e qetë dhe e përshtatshme për votim të lirë dhe të pa ndikuar si bazament i një procesi demokratik zgjedhor.

Nëse subjekti të cilit i është shqiptuar dënimi nuk e paguan të njëjtin brenda afatit të përcaktuar në dispozitiv të tij, atëherë në pajtim me nenin 120.2 të LZP-së, subjektit do ti shqiptohet dënim shtesë. Ky paralajmërim për dënim shtesë është përcaktuar me nenin 120.2 të LZP, i cili përcakton: “ 120.2 Dështimi për të paguar dënimin apo për t’ju bindur një urdhërese të PZAP-it brenda periudhës kohore të saktësuar në vendimin e PZAP-it, është një shkelje tjetër e këtij ligji që mund të sanksionohet me dënim shtesë nga PZAP-i. ”, ashtu siç është vendosur në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi.

Paneli mbi bazën e të dhënave të lartcekuar në mbështetje të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.654/2021 më datë 20.10.2021



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.